

PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT TË KOSOVËS ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* TË BE-SË: SFIDAT DHE PERSPEKTIVAT

***Jeton BYTYQI¹**

Abstrakt:

Qëllimi kryesor i këtij punimi është që të diskutojë përafrimin e legjislacionit të Kosovës me atë të BE-së në rrugën drejt anëtarësimit në familjen e madhe të Bashkimit Evropian. Së pari, punimi do të diskutojë, shkurtimisht, kushtet që duhet të plotësohen për anëtarësim në BE si dhe relacionet e BE-së me Kosovën. Së dyti, punimi do të diskutojë bazën ligjore për përafrimin e legjislacionit në Kosovë si dhe institucionet përgjegjëse për këtë proces. Punimi do të përfundojë me diskutimin e arritjeve, sfidat e paraqitura gjatë këtij procesi si dhe mënyrat për të përmirësuar gjendjen e tanishme.

Në këtë punim do të argumentohet se me gjithë reformat e bëra si dhe krijimin e institucioneve për përafrimin e legjislacionit të Kosovës me atë të BE-së, ende mbeten prezent të meta dhe sfida.

Fjalët kyç: *Kosovë, Bashkimi Evropian (BE), përafrimi ligjor, *acquis communautaire*, integrimi evropian.*

* *Jeton Bytyqi*, LL.M (Leuven), Përfitues i Bursës për Studime post-diplomike: Skema e Celulës së të Rinjve (Young Cell Scheme) e Financuar nga Bashkimi Evropian në Bashkëpunim me Zyrën e Kryeministrit të Qeverisë së Kosovës. Mendimet e shprehura në këtë punim janë personale nuk shprehin mendimin e institucionit për të cilin ai punon.